



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 106 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 26/07 / 2023

VENDIM

Nr.24, date 26 /07/2023

PËR

AKTIN E KOLAUDIMIT TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT PËR REHABILITIMIN E DIGËS PASKUQAN QE SHFRYTEZOHET NGA BASHKIA KAMEZ

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Neni 24, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 26.07.2023 mori në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar nga Bashkia Kamez në lidhje me procesin e kolaudimit të punimeve të zbatimit për projektin e rehabilitimit të digës së Paskuqanit, faza II. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur u verejt se mungonin situacioni perfundimtar i punimeve të kryera dhe vizatimet me të dhenat e ndertimit faktik të digës, relacioni në lidhje me kontrollin dhe provat e materialeve të ndertimit të të vendosura në objekt të percaktuara në nenin 22 dhe 23 të VKM se mesiperme dhe të kerkuara në Vendimin e KKDM Nr. 07, date 27.11.2020 për miratimin e projektit në fjale. Gjithashtu, në dokumentacionin e paraqitur nuk jepen licencat e grupit që ka kryer aktin e kolaudimit si dhe informacion në lidhje me ekonomistin dhe juristin që duhet të jete në këtë grup sipas kërkesave të nenit 24 të VKM se mesiperme. Gjithashtu, rezultoi se nuk janë plotësuar kërkesat e nenit 24, pika 2 të VKM se mesiperme. Nga dokumentacioni i kolaudimit të paraqitur thuhet se janë kryer ndryshime në projekt në një kohë që sipas legjislacionit në fuqi, çdo ndryshim në projekt duhet të miratohet nga KKDM.

Gjate mbledhjes u diskutua në lidhje me problematikat e konstatuara gjate procesit të kolaudimit të punimeve për rehabilitimin e kesaj dige sic jane mosplotesimi i kërkesave të nenit 21, 22, 23, 24, 31, 32 të VKM Nr. 147 së mësipërme, etj. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve, KKDM

VENDOSI:

- 1- **Të mos miratoj aktin e kolaudimit të punimeve të zbatimit për Rehabilitimin e digës së Paskuqanit, Faza II** të paraqitur nga Bashkia Kamez.
- 2- Ti kërkoj shfrytëzuesit të digës së se Paskuqanit, Bashkisë Kamez
 - Te kryejë Kolaudimin e punimeve të zbatimit për rehabilitimin e digës së Paskuqanit, faza e II sipas kërkesave të nenit 24 të VKM Nr. 147, dt. 18.03.2004 brenda muajit Shtator 2023
 - Te njoftoj KKDM sipas VKM se mesiperme brenda muajit Gusht 2023 për kryerjen e Kolaudimit të punimeve të zbatimit për rehabilitimin e digës së Paskuqanit, faza II
 - Te plotësoj të gjithë dokumentacionin e duhur teknik sipas kërkesave të mesiperme duke përfshirë edhe Situacionin e detajuar perfundimtar për të gjithë zerrat e punimeve të kryera, vizatimet e punimeve sipas faktit, Relacionin në lidhje me kontrollin dhe provat e materialeve të ndertimit sipas kërkesave të nenit 22 dhe 23 të VKM se mesiperme.
 - Te paraqesë Aktin e ri të kolaudimit të kryer sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe kërkesave të mesiperme për miratim në KKDM brenda muajit Tetor 2023. Akti i kolaudimit duhet të kryhet nga një grup kolaudimi me licence në fushën e mbikqyrjes dhe kolaudimit të punimeve në digat e mëdha. Në përberje të grupit duhet të marrin pjesë edhe Ekonomistë dhe juristë si dhe përfaqësues të KKDM sipas kërkesave të nenit 24 të VKM Nr. 147.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

3- Ti kerkoj Bashkise Kamez si shfrytezuese e diges se Paskuqanit:

- Hartimin dhe Dorezimin brenda muajit Tetor 2023 te Rregullores se shfrytezimit, mirembajtjes, monitorimit dhe Sigurise se diges se Paskuqanit duke u bazuar ne kushtet e reja te operimit dhe shfrytezimit te kesaj dige per qellime urbane dhe njoftimin per ndryshimin e destinacionit te perdorimit te kesaj dige prane KKDM, MIE, MBZHR
- Hartimin dhe dorezimin para sezonit te rreshjeve te Planit te Gadishmerise se emergjencave civile per shkak te prishjes se mundshme te diges apo plotave maksimale te rreshjeve. Ky Plan duhet te shoqerohet me kurbat e volumeve dhe siperfaqeve aktuale te ujit ne rezervuar ne kushtet e reja te operimit dhe shfrytezimit te diges, skenaret si dhe hartat e permbytjeve ne zonen urbane poshte diges
- Instalimin e nje sistemi Alarmi ne zonen e diges per shkak te rrishtit shume te larte te zones urbane poshte diges se Paskuqanit

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM per ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në kete Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

